



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 250, datë 24.12.2019

MBI

FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2020

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 45 e vijues të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Fondi i Kompensimit krijohet bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve pasurore dhe jo pasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur dëmet shkaktohen nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i siguruar sipas ligjit nga ndonjë shoqëri sigurimi, nga një mjet motorik i pidentifikuar apo në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie sigurimi.

Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3, shkronja b e këtij neni dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Referuar nenit 7, të Rregullores nr. 119, datë 06.06.2019 “Mbi administrimin e Fondit të Kompensimit”, si dhe pikës 1 të nenit 7, të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së BSHS-së”, e ndryshuar, Byroja brenda datës 30 nëntor të çdo viti, i propozon për miratim Autoritetit shumën e kontributeve të çdo shoqërie sigurimi për financimin e Fondit të Kompensimit të vitit pasardhës.

Autoriteti miraton çdo vit brenda datës 31 dhjetor, shumën e këtyre kontributeve.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të BSHS-së në mbledhjen e datës 5 dhjetor 2019, shqyrtoi Fondin e Kompensimit, situatën e çështjeve gjyqësore dhe propozoi që masa e kontributit për Fondin e Kompensimit të vitit 2020, të jetë 311,215,112 lekë.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve më datë 23.12.2019, mori vendimin nr. 27, datë 23.12.2019 “Për miratimin e shpërndarjes së masës së kontributit për fondin e kompensimit për vitin 2020”. Ky vendim është depozituar me e-mail nga BSHS-së më datë 23.12.2019, si dhe me shkresën nr. 7861 prot, datë 24.12.2019.

Nga relacioni shoqërues i këtij propozimi, referencë janë të dhënat e dëmeve pezull të vëna në dispozicion nga Byroja, por analiza e këtij fondi i referohet vlerës së fondit të miratuar nga Asambleja dhe jo vlerës së fondit të miratuar nga Autoriteti.

Referuar të dhënave të paraqitura nga BSHS në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve në datën 5 dhjetor 2019, depozituar në Autoritet nëpërmjet e-mail të datës 10 dhjetor 2019, situata paraqitet:

Periudha e ngjarjes	Ngjarje deri 31.12.2013		Ngjarje pas 1 janar 2014		TOTALI
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	
Sipas statusit të praktikës					
1. Dëme të miratuara por të papaguara					
1.1 Dëme të miratuara të papaguara	45	37,136,586	60	47,550,576	84,687,162
1.2 Dëme të miratuara pa paguar rasti Kosovë	32	712,412			712,412
Total (1.1+1.2)	77	37,848,998	60	47,550,576	85,399,574
2. Dëme të ekzekutueshme					
2.1 Të ekzekutueshme me vendim gjyq	10	22,971,774	15	50,959,879	73,931,653
2.2 Përmbartimore	65	160,291,325	13	38,765,242	199,056,567
Total (2.1+2.2)	75	183,263,099	28	89,725,121	272,988,220
TOTAL PËR PAGESË	152	221,112,097	88	137,275,697	358,387,794
3. Dëme në proces të papaguara					
3.1 Dëme në proces trajtimi	12	15,337,428	108	82,628,099	97,965,527
3.2 Dëme në proces gjyqësor shkalle e pare	6	10,598,650	96	257,897,313	268,495,963
3.3 Dëme në proces gjyqësore Apel	19	125,427,142	50	190,428,053	315,855,195
3.4 Dëme në proces gjyqësore Shkallë e lartë	24	122,658,047	3	24,228,116	146,886,163

<i>Detyrimi për Dëme Pezull Fond Kompensimi</i>	<i>61</i>	<i>274,021,267</i>	<i>257</i>	<i>555,181,581</i>	<i>829,202,848</i>
---	-----------	--------------------	------------	--------------------	--------------------

Bazuar në vendimin e Bordit nr. 260, datë 28.12.2018, shoqëritë e sigurimit duhet të raportojnë në pasqyrat financiare me datë 31.12.2019, provigjon për shpenzime për Fond Kompensimi, vlerën 382,784,517 lekë, që i përket praktikave në proces trajtimi dhe në proces gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Referuar tabelës së mësipërme, dëmet në proces trajtimi dhe në proces gjyqësor me datë 30.11.2019 janë në vlerën 829,202,848 lekë, vlerë e cila përfshin provigjonin për shpenzim sipas vendimit të Bordit nr. 260, datë 28.12.2018.

Aktualisht, sipas raportimit periodik të BSHS-së për pagesat e raportuara deri më datë 30.11.2019, rezulton se vlera e mbetur nga fondi për vitin 2019, është e mjaftueshme për pagesën e dëmeve të miratuara por të papaguara (të ekzekutueshme).

Në këto kushte, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Fondi i Kompensimit për vitin 2020, është në masën 446,418,331 lekë.
2. Shoqëritë e sigurimit të vijojnë me pagesat e praktikave me datë ngjarje më të hershme.
3. Byroja Shqiptare e Sigurimit të llogaritë, të shpërndajë dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive të Fondit të Kompensimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Fondi i Kompensimit sipas pikës 1 të këtij vendimi do të rishikohet në fund të çdo tremujori.
5. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike, Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin e vendimit, ndjekjen e raportimeve, kryerjen e inspektimeve dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI